



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality

Kuvendi Komunal
01. Nr.060/01-13199/2
Dt. 28.06.2018
Dragash

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28, qershor 2008), nenit 7, paragrafi 3 të Ligjit 04/L-144 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.35/17 dhjetor 2012), nenit 5 të Rregullores QRK 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 32, paragrafi 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 i dt. 11.09.2008, pas shqyrtimit të Propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.28.06.2018, miraton këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN PARAPRAKE NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS NË PRONËSI KOMUNALE

I. MIRATOHET Propozimi i Kryetarit të Komunës së Dragashit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 5 viteve të pronës dhe lokaleve në pronësi të Komunës që gjenden në parcelat kadastrale:

1.1 Në pronësi të Komunës parcela kadastrale **P-70604014-009005-1 ZK Dragash** Tregu i gjelbër dhe ngastrave kad. **878-0, 881-0, 882-0, 883-0, 884-0, 886-0.**

1.2. Në pronësi të Komunës parcela kadastrale **P-70604014-00782-0 ZK Dragash** - Auto parkingu te Posta dhe Gjykata,

1.3. Në pronësi të Komunës parcela kadastrale **P-70601014-00781-0, ZK Dragash** Lokali nr. 1 (afër postës) "Venecia",

1.4. Në pronësi të Komunës parcela kadastrale **P- 70604014-00771-0 ZK Dragash** Bufeja në shtëpinë e kulturës.

II. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën **I** të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, si dhe rritja e të hyrave vetanake.

- III. Për shkak të natyrës së objekteve dhe banuesve të cekura në pikën **1.3 dhe 1.4**, në këto lokale nuk mund të vendoset skara.
- IV. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes Ankandit Publik, që e zbaton Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me Komisionin Komunal për Vlerësim të Pronës Komunale.
- V. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës me shfrytëzuesit e pronës Komunale do të rregullohen me Kontratë të veçantë, të nënshkruar nga Kryetari i Komunës.
- VI. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset, Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës, organi kompetentë për pronë dhe organi kompetentë për regjistrimin e pronës së paluajtshme.
- VII. Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në protokolin e MAPL-së për vlerësim të ligjshmërisë, si 7 ditë pas publikimit në web-faqen e Komunës.

I dërgohet:

- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore) – Prishtinë,
- Zyrës Prokurimit – Dragash,
- Drejtoratit për Ekonomi, Financa e Zhvillim të Komunës – Dragash dhe
- Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Betim Merdiu